



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr. 1739/16 prot.

Datë 29.08.2024

V E N D I M
Nr. 1142/2024

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Fiorent Zguro	Nënkryetar
Kreshnik Ternova	Anëtar
Anila Malaj	Anëtar
Gjergj Mersini	Anëtar

Në mbledhjen e datës 29.08.2024, mori në shqyrtim çështjen me,

Objekt:

Mbi zbatimin e vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 1048/2024, datë 14.08.2024 për procedurën e prokurimit “Procedurë e hapur”, me Nr. REF-05441-05- 20-2024 me objekt “Loti 4, Blerje Kite, Reagente dhe materiale konsumi per laboratorin per aparatn Maglum 800 / ose ekuivalent i tij” me fond limit 7 260 000 lekë pa TVSH, zhvilluar në datën 11.06.2024 nga autoriteti kontraktor, Qendra Shendetesore e Specialiteteve Nr.1.

Ankimues:

Operatori Ekonomik “Genius” SHPK, me NUIS K63121801C, me adresë: Lagjja Nr.3, Rruga Jurgen Trade, Laboratori perballe ish Spitalit, Tiranë

Autoriteti Kontraktor:

Qendra Shendetesore e Specialiteteve Nr.1, me adresë: Rr. “Vllazen Huta”, Tirane

Baza Ligjore:

Ligji nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik, i

ndryshuar, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik nr.766/2021, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksonimin e Komisionit të Prokurimit Publik”

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi shqyrtoi dokumentacionin e çështjes dhe e diskutoi në tërësi,

Vëren:

I

Rrethanat e çështjes

I.1 Në datë 14.08.2024, Komisioni i Prokurimit Publik mori vendimin Nr. 1048/2024, ku vendosi:

- 1. Të pranohet ankesën e operatorit ekonomik “Genius” SHPK për procedurën e prokurimit “Procedurë e hapur”, me Nr. REF-05441-05-20-2024 me objekt “Loti 4, Blerje Kite, Reagente dhe materiale konsumi per laboratorin per aparatit Maglum 800 / ose ekuivalent i tij” me fond limit 7 260 000 lekë pa TVSH, zhvilluar në datën 11.06.2024 nga autoriteti kontraktor, Qendra Shendetesore e Specialiteteve Nr.1.*
- 2. Autoriteti kontraktor të anulohet vendimin e KVO-së për kualifikimin e operatorit ekonomik "Swissmed" SHPK duke e skualifikuar atë.*
- 3. Autoriteti kontraktor, brenda 5 diteve, të verë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e këtij vendimi duke dokumentuar veprimet e kryera.*
- 4. Ngarkohet zyra e financës të kryejë veprimet për kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik "Genius" SHPK.*
- 5. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit.*
- 6. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencise së Prokurimit Publik.*

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

I.2 Me shkresën nr. 687 prot., datë 23.08.2024, protokolluar me tonën nr. 1739/13 prot., datë 27.08.2024 autoriteti kontraktor, njofton se ka zbatuar vendimin e Komisionit të Prokurimit Publik nr 1048/2024, datë 14.08.2024 për procedurën e prokurimit "Procedurë e hapur", me Nr. REF-05441-05-20-2024 me objekt “Loti 4, Blerje Kite, Reagente dhe materiale konsumi per

laboratorin per aparatin Maglum 800 / ose ekuivalent i tij” me fond limit 7 260 000 lekë pa TVSH, zhvilluar në datën 11.06.2024 nga autoriteti kontraktor, Qendra Shendetesore e Specialiteteve Nr.1.

II

Komisioni i Prokurimit Publik

Pasi shqyrtoi dokumentacionin e mësipërm,

Arsyeton

II.1 Me shkresën nr. 687 prot., datë 23.08.2024, protokolluar me tonën nr. 1739/13 prot., datë 27.08.2024 autoriteti kontraktor, njofton se ka zbatuar vendimin e Komisionit të Prokurimit Publik nr 1048/2024, datë 14.08.2024 për procedurën e prokurimit " Procedurë e hapur", me Nr. REF-05441-05-20-2024 me objekt “Loti 4, Blerje Kite, Reagente dhe materiale konsumi per laboratorin per aparatin Maglum 800 / ose ekuivalent i tij” me fond limit 7 260 000 lekë pa TVSH, zhvilluar në datën 11.06.2024 nga autoriteti kontraktor, Qendra Shendetesore e Specialiteteve Nr.1.

II.2 Komisioni i Prokurimit Publik verifikoi ne sistem rivlersimin e kryer nga autoriteti kontraktor në zbatimin e vendimit Nr. 1048/2024, date 14.08.2024 te Komisionit të Prokurimit Publik. Nga ky verifikim rezultoi se, autoriteti kontraktor kreu rivleresimin ne sistemin e prokurimit elektronin (SPE) te ofertave, duke skualifikuar operatorin ekonomik "Swissmed" SHPK, ne zbatim te vendimit te KPP Nr.1048/2024, date 14.08.2024.

II.3 Sa me siper, autoriteti kontraktor Qendra Shendetesore e Specialiteteve Nr.1 ka zbatuar vendimin Nr 1048/2024 datë 14.08.2024 të Komisionit të Prokurimit Publik, për procedurën e prokurimit objekt shqyrtimi.

Për sa më sipër, në mbështetje të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, Vendimin e Komisionit të Prokurimit Publik nr.766/2021, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funkcionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

Vendos:

1. Të lejojë autoritetin kontraktor për vijimin me hapat e mëtejshëm të procedurës "Procedurë e hapur", me Nr. REF-05441-05-20-2024 me objekt "Loti 4, Blerje Kite, Reagente dhe materiale konsumi per laboratorin per aparatn Maglum 800 / ose ekuivalent i tij" me fond limit 7 260 000 lekë pa TVSH, zhvilluar në datën 11.06.2024 nga autoriteti kontraktor, Qendra Shendetesore e Specialiteteve Nr.1.
 2. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Anëtar
Kreshnik Ternova

Anëtar
Anila Malaj

Anëtar
Gjergj Mersini

Nënkryetar
Fiorent Zguro

